

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXV, nr. 7964
E martë, 7 janar 2025
Çmimi 0.50 €

IKShPK-ja jep këshilla
se si të parandalohet
virusi i ri kinez I FAQE 5



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

PARTITË POLITIKE PAJISEN ME NUMRA, BËHEN GATI PËR FUSHATË I FAQE 4-5



Subjektet politike në Kosovë janë pajisur me numra me të cilët do të garojnë në zgjedhjet e rregullta parlamentare të 9 shkurtit, pasi Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka organizuar të hënën hedhjen e shortit për renditjen në fletëvotime.

Numrat e subjekteve politike në fletëvotime janë nga 111 deri në 138. Sipas këtij shorti, Lëvizja Vetëvendosje do të garojë me numrin 118, PDK-ja me numrin 131, LDK-ja me numrin 124 dhe Koalicioni AAK-Nisma me numrin 137.

Këto janë përgatitjet e fundit të KQZ-së për zgjedhjet, teksa fushata zgjedhore do të nisë të shtunën, më 11 janar, dhe për një muaj partitë dhe kandidatët do të tentojnë t'i bindin votuesit të votojnë për ta

**KMDLNJ-JA:
GJYKATA SPECIALE,
NJË STËRKEQE JURIDIKE
QË ME ASGJË
NUK I PËRGJIGJET
THEMELUESIT, KUVENDIT
TË KOSOVËS F. 3**




**VITI I
ZGJEDHJEVE
DHE SFIDAVE
DREJT
STABILITETIT F. 7**



**ZELENSKY KËRKON GARANCI
TË SIGURISË NGA SHBA-ja F. 4**

EKONOMI



**ENDE NUK KA NJË PËRPARIM NË
APPLEPAY DHE NË PAYPAL F. 8**

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 735
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji
BIZNESI**
www.kolegjbiznesi.com
info@kolegjbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Zelensky kërkon garanci të sigurisë nga ShBA-ja

KIEV, 6 JANAR - Presidenti ukrainas Volodymyr Zelensky tha se çdo garanci e sigurisë për shtetin e tij në mënyrë që t'i jepet fund luftës me Rusinë do të ishte kuptimplotë vetëm nëse do të jepej nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Ai tha se shpreson se do të takohet shpejt me presidentin e zgjedhur amerikan Donald Trump, pas inaugurimit të tij më 20 janar. "Pa ShBA-në, garancitë e sigurisë nuk janë të mundura", tha ai në një intervistë triorëshme me Lex Fridman, që u publikua më 5 janar. "Po flas për garanci të sigurisë që mund ta parandalojnë agresionin rus", shtoi ai.

Gjatë kësaj interviste, që u zhvillua në Kiev, Zelensky foli në gjuhën angleze, ukrainase, madje edhe ruse. Ai tha se beson se një armëpushim pa garanci të sigurisë për Kievin do të përdorej nga Kremli si një mundësi për t'u furnizuar dhe riorganizuar për ofensiva të reja. Teksa përvjetori i tretë i nisjes së pushtimit rus të Ukrainës po afrohet, vdekjet dhe shkatërrimi po vazhdojnë në shumë qytete ukrainase, veçmas në lindje dhe në territorin e pushtuar nga forcat e Kremlinit, por edhe në Kursk, rajonin kufitar rus. Kohë të pasigurta po e presin Kievin, teksa Trumpi pritet të

rikthehet në Shtëpinë e Bardhë më 20 janar.

Trump, i cili ka qenë kritik për sasinë e ndihmës së ofruar amerikane për Ukrainën, vazhdimisht është zotuar se do t'i japë fund shpejt konfliktit, edhe pse për këtë ai ka dhënë pak hollësi. Shumë mbështetës të Ukrainës janë të shqetësuar se ai do të shtyjë përpara kushte që do të jenë të papranueshme për Kievin.

Përpjekjet për një armëpushim janë të pashmangshme, në dritë të premtimeve të Trumpit për t'i dhënë fund luftës në një periudhë të shkurtër kohore. Administrata në largim e presidentit Joe Biden në katër vjetët e fundit i ka dhënë Ukrainës ndihmë ushtarake dhe ndihmë tjetër në vlerë prej afër 60 miliardë dollarësh.

Zelensky ka një histori të gjatë dhe të vështirë me Trumpin.

Gjykimi i parë ndaj Trumpit për shkarkimin e tij nga posti i presidentit më 2019 u nxit nga një bisedë telefonike që ai kishte zhvilluar me Zelenskyn, në të cilin Trumpi dukej se kishte kushtëzuar ndihmën ushtarake amerikane në këmbim të hetimit nga Ukraina të familjes së Bidenit.

Trumpi disa herë e ka kritikuar Zelenskyn. Gjatë fushatës zgjedhore ai vazhdimisht e ka



përshkruar presidentin ukrainas si "tregtarin më të mirë në botë" - referencë për dhjetëra miliarda dollarë ndihmë që ligjvënësit e dy partive në ShBA kanë miratuar që kur ka nisur pushtimi rus i Ukrainës në shkurtin e vitit 2022.

Megjithatë, gjatë intervistës Zelensky tha se është i bindur se Trumpi do të sjellë një marrëveshje të drejtë, të

qëndrueshme të paqes, së bashku me garancitë e kërkuara të sigurisë. "Trumpi dhe unë do të arrijmë deri te një marrëveshje... të ofrojë garanci të forta të sigurisë, së bashku me Evropën, dhe më pas ne mund të flasim me rusët. Ne dhe Trumpi jemi të parët, dhe Evropa do ta mbështesë pozicionin e Ukrainës", tha ai. "Mendoj se presidenti Trump jo

vetëm që ka vullnet, por i ka të gjitha mundësitë dhe këto nuk janë vetëm fjalë". "Unë vërtet llogarisë në të dhe mendoj se njerëzit tanë vërtet llogarisin në të, prandaj ai ka fuqi të mjaftueshme për t'i bërë presion atij, për t'i bërë presion [presidentit rus, Vladimir] Putin", shtoi Zelensky.

I pyetur se çfarë kërkon ta shqyrtojë një armëpushim, Zelensky tha se janë garancitë e sigurisë, mundësisht përfshirja në NATO, diçka që Putini e ka kundërshtuar me forcë.

Anëtarësimi në NATO ishte një nga argumentet fillestare që Kremli përdori për ta justifikuar luftën kundër Ukrainës.

Për çdo marrëveshje Zelensky tha se partnerët perëndimorë të paktën duhet të garantojnë sigurinë në territorin ukrainas që aktualisht nuk është i pushtuar nga Rusia, ta vazhdojnë mbështetjen ushtarake dhe t'i mbajnë në fuqi sanksionet ekonomike ndaj Rusisë. "Nëse nuk ka garanci të sigurisë, Putini sërish do të sulmojë", tha ai. Sipas tij, qëllimet e Putinit janë një "NATO e dobët" dhe një "Ukrainë që nuk mund të mbijetojë në fushëbetëje" dhe "të pamundësohet një raport i fortë me Trumpin".

Kancelari austriak do të japë dorëheqje pasi dështoi ta formojë qeverinë e re

VJEN, 6 JANAR - Kancelari i Austrisë, Karl Nehammer, ka thënë se do të japë dorëheqje në ditët në vijim si kancelar dhe si lider i partisë, pas dështimit të bisedimeve për të formuar një koalicion qeveritar. Kancelari ka thënë se partia e tij, Partia Popullore konservative dhe Social Demokratët, nuk janë pajtuar për çështjet kryesore.

Neoliberalët, një tjetër parti e përfshirë në bisedime, është tërhequr të premten.

Në shtator, Partia e Lirisë, e së



djathtës ekstreme, ka shënuar fitore të pashembullt në zgjedhjet e përgjithshme të Austrisë, mirëpo partitë e tjera patën thënë

se nuk formojnë koalicion me liderin e këtij subjekti politik Herbert Kickl.

Kolapsimi i bisedimeve mund të rezultojë me nisjen e bisedimeve të konservatorëve me të djathtën ekstreme, apo edhe me organizim të zgjedhjeve të reja, vlerësojnë analistët.

Partia e Lirisë, miqësore me Rusinë, ka qenë më parë në pushtet. Ajo duket se do t'i mirëpriste zgjedhjet e reja, pasi sondazhet e opinionit publik

sugjerojnë për rritjen e mëtejme të saj edhe pas shtatorit. Kjo parti e ka kritikuar presidentin e shtetit, Alexander Van der Bellen, për "kaosin e krijuar dhe kohën e humbur".

Dalja në zgjedhjet e shtatorit ka qenë 77.3 për qind, ndërsa temat kryesore kanë qenë ato të migrimit, azilit dhe ekonomisë në kohën e luftës së Rusisë në Ukrainë.

Kickl pati premtuar se do ta rikthente sigurinë për austriakët.

Partia që udhëheq ai është e ashpër për çështjet e migrimit dhe e promovon idenë e rimigrimit, që përfshin dërgimin e azilkërkuësve në shtetet e origjinës.

Partia e Lirisë është themeluar nga ish-nazistët në vitet '50.

Dy ditë para zgjedhjeve të shtatorit, disa kandidatë janë zënë duke kënduar në një funeral këngë të nazistëve, ndonëse partia më vonë ka mohuar gjithçka.

ShBA, priten reshjet më të mëdha të dëborës prej një dekade

UASHINGTON, 6 JANAR - Një valë dëbore, akulli, erërash dhe temperaturat në rënje krijuan kushte të rrezikshme për udhëtimin në disa pjesë qendrore të Shteteve të Bashkuara të dielën, pasi një stuhi dimërore pritet të sjellë mundësinë e "reshjeve më të mëdha të dëborës prej një dekade" në disa zona.

Bora dhe akulli mbuluan rrugët kryesore në pothuajse të gjithë Kansasin, Nebraskën

perëndimore dhe pjesë të Indianës, ku Garda Kombëtare e këtij shteti u aktivizua për t'i ndihmuar udhëtarët e bllokuar në makina. Pritej të paktën 20 centimetra dëborë, pasi Shërbimi Kombëtar i Motit qarkulloi paralajmërime për stuhi dimërore për shtetet Kansas dhe Missouri.

Paralajmërimi u shtri edhe në New Jersey për të hënën dhe deri në orët e para të së martës. "Për vendet në këtë rajon që do

të kenë sasitë më të mëdha të borës, mund të jenë reshjet më të mëdha në të paktën një dekade", tha shërbimi i motit të dielën herët.

Rreth 63 milionë amerikanë banojnë në zonat që mund të preken të dielën, sipas specialistit Bob Oravec, me Shërbimin Kombëtar të Motit.

Vorbulla polare e ajrit tepër të ftohtë zakonisht rrotullohet përreth Polit të Veriut. Njerëzit në Shtetet e Bashkuara, Evropë



dhe Azi e përjetojnë të ftohtin e tij intensiv kur rrymat e ajrit zhvendosen drejt jugut. Studimet tregojnë se ngrohja e

shpejtë në Arktik është pjesërisht shkak për frekuencën në rritje të vorbullës polare që zgjeron ndikimin e saj të akullit.

Stuhia pritet të përfshijë edhe kryeqytetin Uashington dhe rrethinat e tij.

Shërbimi Kombëtar i Motit parashikoi nga 20 deri në 30 centimetra dëborë për zonën e Anapolisit, Maryland, me temperatura të mbetura nën zero gjatë gjithë fundjavës.

KMDLNj-ja: Gjykata Speciale, një stërkeqe juridike që me asgjë nuk i përgjigjet themeluesit, Kuvendit të Kosovës



Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe të Lirive të Njeriut (KMDLNj) shpreson se legjislatura e ardhshme e Kuvendit të Kosovës do të jetë më e përgjegjshme në raport me gjykimin e ish-krerëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. “KMDLNj shpreson se përbërja e ardhshme e Kuvendit të Kosovës do të jetë më e përgjegjshme, profesionalisht dhe institucionalisht duke amandamentuar Ligjin për Gjykatën Speciale duke kërkuar transparencë, llogaridhënie dhe afatizim të punës”, është thënë në reagimin e KMDLNj-së

**EPOKA
ERE** **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 6 JANAR - Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe të Lirive të Njeriut (KMDLNj) ka theksuar përmes një reagimi për medie se Dhomat e Specializuara apo Gjykata Speciale është një stërkeqe juridike që me asgjë nuk i përgjigjet themeluesit - Kuvendit të Kosovës ndonëse, sipas KMDLNj-së, edhe institucionet e vendit deklarohen se është pjesë e sistemit të drejtësisë sikurse që edhe vetë Gjykata Speciale e thotë të njëjtën gjë. “Në anën tjetër kjo gjykatë me asgjë nuk identifikohet me sistemin e drejtësisë së Kosovës, as me logo, as me ndonjë shenjë tjetër identifikuese. Kurrë dhe asnjëherë nuk i ka raportuar apo informuar Kuvendin e Kosovës sepse krejt sovranitetin vendimmarrës e

raporton në Bruksel dhe Serbi. Ekskluzivitetin për monitorim brenda burgut e ka Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq i Gjenevës dhe Avokati i Popullit i Holandës. Brenda këtij burgu është edhe një Ombudsman që nuk i trajton ankesat e të burgosurve, shtetas të Kosovës dhe të gjithë shqiptarë, por trajton vetëm të drejtat e njeriut të të punësuarve në këtë monstrum juridik”, është thënë në reagimin e KMDLNj-së. KMDLNj-ja ka theksuar se monitorimi i procesit gjyqësor bëhet vetëm pjesërisht për shkak se shumë seanca janë të mbyllura për publikun. “Gjykata Speciale në Hagë në mënyrë brutale e dhunon parimin e publicitetit sikur që është jashtëzakonisht jotransparente dhe i mungon, si nga forma ashtu edhe nga përmbajtja, llogaridhënia. KMDLNj vazhdimisht ka

këmbëngulur që Kuvendi i Kosovës, si ‘themelues’, të mbajë një apo më shumë seanca ku do të kërkohej transparencë dhe llogaridhënie për trajtimin e pengjeve të Hagës e që në asnjë mënyrë nuk do të merrej si ndërhyrje në punën e kësaj gjykate. Deputetët e Kuvendit të Kosovës, të ndarë në baza partiake dhe politike, nuk e kanë bërë as përpjekjen më të vogël ta luajnë rolin e të zgjedhurit të popullit dhe përmbushjen e mandatit detyrues për përfaqësim dhe mbrojtje të të drejtave të njeriut, përkatësisht të drejtave të njeriut të personave të privuar nga liria. KNKK nga Gjeneva nuk ka kohë t’i takojë të burgosurit dhe t’i dëgjojë shqetësimet e arsyeshme, kurse Avokati i Popullit i Holandës nuk merret fare me këtë çështje dhe nuk i njej autoritetet kosovare”, është thënë në këtë reagim.

KMDLNj ka thënë tutje se pengjet në Hagë janë vizituar nga deputetë të Kuvendit, nga Komisioni për të Drejtat e Njeriut i Kuvendit, nga ministra, z/kryeministra dhe nga kryetari i Kuvendit, por jo edhe nga presidentja Vjosa Osmani dhe kryeministri Albin Kurti. “Presidentja dhe KM i Kosovës nuk e kanë treguar as interesimin më të vogël për t’i vizituar që, sipas KMDLNj-së është qasje diskriminuese. Edhe vizitat janë bërë selektive, për turizëm, për selfie dhe për përfitime politike dhe materiale. Sidomos materiale shkak se përveç rrogës së majme, kanë marrë edhe mëditje për këto vizita. Më parë kryetari i Kuvendit kishte kërkuar një mekanizëm monitorues dhe kjo ishte e tëra që e bëri. Ishte mashtrim ordiner. Një muaj para zgjedhjeve parlamentare dhe para përfundimit të mandatit, ministrja e Drejtësisë kërkoi të

formohet një mekanizëm vendor a ndërkombëtar për monitorim ndonëse nuk ka lënë gurë pa lëvizur t’ua bënë jetën sa më të rëndë dhe t’ua pakësojë mundësitë për një mbrojtje efektive. KMDLNj deklaroi se këto janë deklarata mashtruese, për përdorim të brendshëm, për përfitime politike dhe blerje të votave. Të gjitha këto shkelje ishin identifikuar nga KMDLNj por se nuk janë përfillur nga ‘kërkuesit’ e formimit të këtij mekanizmi. Reagimet e KMDLNj-së kanë qenë të shumta. KMDLNj ia përkujton opinionit se asnjë vizitë nga Kosova pavarësisht cilit institucion i përkasin nuk llogaritet si vizitë zyrtare por si vizitë private apo familjare që tregon qartë shpërfilljen që ua bënë gjykata edhe përfaqësuesve më të lartë institucionalë”, thuhet në reagimin e KMDLNj-së. KMDLNj shpreson se përbërja e ardhshme e Kuvendit të Kosovës do të jetë më e përgjegjshme, profesionalisht dhe institucionalisht duke amandamentuar Ligjin për Gjykatën Speciale duke kërkuar transparencë, llogaridhënie dhe afatizim të punës. “Ose, që do të konsiderohej e përgjegjshme dhe minimalisht e ndershme të deklarohet botërisht se kjo gjykatë nuk është, me asgjë e Kosovës”, thuhet në reagimin e KMDLNj-së.

KMDLNj: Presidentja dhe kryeministri nuk treguan as interesimin më të vogël për t’i vizituar të arrestuarit në Hagë

KMDLNj ka thënë tutje se pengjet në Hagë janë vizituar nga deputetë të Kuvendit, nga Komisioni për të Drejtat e Njeriut i Kuvendit të Kosovës, nga ministra, z/kryeministra dhe nga kryetari i Kuvendit, por jo edhe nga presidentja Vjosa Osmani dhe kryeministri Albin Kurti. Presidentja dhe KM i Kosovës nuk e kanë treguar as interesimin më të vogël për t’i vizituar që, sipas KMDLNj-së, është qasje diskriminuese.



Partitë politike pajisen me numra, bëhen gati për fushatë

Subjektet politike në Kosovë janë pajisur me numra me të cilët do të garojnë në zgjedhjet e rregullta parlamentare të 9 shkurtit, pasi Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka organizuar të hënën hedhjen e shortit për renditjen në fletëvotime. Numrat e subjekteve politike në fletëvotime janë nga 111 deri në 138. Sipas këtij shorti, Lëvizja Vetëvendosje do të garojë me numrin 118, PDK-ja me numrin 131, LDK-ja me numrin 124 dhe Koalicioni AAK-Nisma me numrin 137. Këto janë përgatitjet e fundit të KQZ-së për zgjedhjet, teksa fushata zgjedhore do të nisë të shtunën, më 11 janar, dhe për një muaj partitë dhe kandidatët do të tentojnë t'i bindin votuesit të votojnë për ta

EPOKA E RE Mal QORRAJ

Prishtinë, 6 janar - Të hënën subjektet politike në Kosovë janë pajisur me numra me të cilët do të garojnë në zgjedhjet e rregullta parlamentare të 9 shkurtit, pasi Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka organizuar hedhjen e shortit për renditjen në fletëvotime. Numrat e subjekteve politike në fletëvotime janë nga 111 deri në 138.

Sipas këtij shorti, Lëvizja Vetëvendosje do të garojë me numrin 118, PDK-ja me numrin 131, LDK-ja me numrin 124 dhe Koalicioni AAK-Nisma me numrin 137.

Për këto zgjedhje janë certifikuar 28 subjekte politike me 1 280 kandidatë.

Në fletëvotim qytetarët do të mund të zgjedhin një subjekt politik dhe deri në dhjetë kandidatë për deputetë. Ky është një ndryshim pas miratimit të Ligjit të ri për Zgjedhjet. Në të kaluarën qytetarët kanë pasur mundësinë të zgjedhin deri në pesë kandidatë.

Secila parti e certifikuar mund të ketë deri në 110 kandidatë në listën zgjedhore. Nga këto lista do të zgjidhet përbërja e re e Kuvendit me 120 ulëse dhe deputetët më pas zgjedhin qeverinë e re. Qeveria aktuale në Kosovë udhëhiqet nga Albin Kurti, kreu i Lëvizjes

Vetëvendosje.

Këto janë përgatitjet e fundit të KQZ-së për zgjedhjet, teksa fushata zgjedhore do të nisë të shtunën, më 11 janar, dhe për një muaj partitë dhe kandidatët do të tentojnë t'i bindin votuesit të votojnë për ta.

Për dallim nga zgjedhjet e kaluara, kur heshtja zgjedhore fillonte një ditë para votimeve, me ndryshimet ligjore të këtij viti ajo tashmë do të fillojë një minutë para hapjes së qendrave të votimit, në orën 07:00 dhe do të zgjasë deri në mbylljen e tyre, në orën 19:00 të 9 shkurtit. Pra, heshtja zgjedhore do të zgjasë vetëm gjatë 12 orëve të votimit. Gjatë përgatitjeve për zgjedhjet e 9 shkurtit një temë prodhoi betejë ligjore: certifikimi i Listës Serbe, pasi më 23 dhjetor përfaqësuesit e Lëvizjes Vetëvendosje në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve votuan kundër certifikimit të Listës Serbe. Përfaqësuesit e partive të tjera abstenuan gjatë votimit.

Lista Serbe është partia kryesore e serbëve në Kosovë që gëzon mbështetjen e Beogradit. Kjo parti më pas u ankuar në Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia. PZAP-ja i dha të drejtë Listës Serbe, duke mos gjetur asnjë shkelje nga kjo parti që do të përbënte bazë për moscertifikim dhe urdhëroi KQZ-në ta certifikojë këtë subjekt.

Reagojnë liderët

Lëvizja Vetëvendosje ka reaguar pas tërheqjes së shortit të subjekteve politike për renditjen në fletëvotim për zgjedhjet e 9 shkurtit. Në "Facebook", LV-ja ka shkruar se "18 është numri i 500 mijë zemrave që rrahin si një". Ndërkaq lideri i PDK-së, Memli Krasniqi, ka thënë se numri 131 i PDK-së është numër i fitores, i besimit dhe i të ardhmes. "Partia Demokratike e Kosovës, me kandidatin tonë për kryeministër, Bedri Hamzën, dhe listën më të mirë të kandidatëve për deputetë, është e mobilizuar dhe e gatshme për fitore në zgjedhjet e 9 shkurtit. Numri 131 na bashkon në vizionin për një Kosovë ma të mirë. Me punë të palodhshme, përkushtim të madh dhe kompetencë të dëshmuar, bashkë do të ndërtojmë një të ardhme më të mirë për çdo qytetar", ka shkruar Krasniqi në "Facebook".

Lideri i LDK-së, Lumir Abdixhiku, ka thënë se 9 shkurti është fitorja e tyre. "9 shkurti është fati jonë, thirrja jonë, fitorja jonë!", ka shkruar Abdixhiku. Kurse lideri i AAK-së, Ramush Haradinaj, ka thënë se me numrin 137, më 9 shkurt, janë Aleanca - Nisma - Konservatorët - Forumi Intelktual E-30 dhe Lista Ideal. "Në numrin 137 është fitorja e Kosovës", ka shkruar Haradinaj.

RENDITJA E PARTIVE NË FLETËVOTIMET PËR ZGJEDHJET E 9 SHKURTIT

111 - Iniciativa e re demokratike e Kosovës (IRDK)	126 - Gradjanska Inicijativa Narodna Pravda
112 - Lista Serbe	127 - Socijaldemokratska Unija (SDU)
113 - Jedinstvena Goranska Partija	128 - Fatmir Bytyqi
114 - Partia Rome e Bashkuar e Kosovës	129 - Koalicioni për Familje
115 - Partia Liberale Egjiptiane (PLE)	130 - Yenilikçi Türk Hareket Partisi
116 - Srpska Demokratija	131 - Partia Demokratike e Kosovës
117 - Partia Balli Kombëtar Demokrat Shqiptar	132 - Za Slobodu Pravdu Opstanak
118 - Lëvizja Vetëvendosje	133 - Srpski Narodni Pokret
119 - Nova Demokratska Stranka	134 - Kosova Demokratik Turk Partisi
120 - Partija Kosovskih Srba	135 - Koalicioni Vakati
121 - Nasa Bošnjacka Koalicija	136 - Opre Roma Kosova
122 - Kosova Adalet Turk Partisi	137 - Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, Nisma, Nisma Socialdemokrate, Lista Konservatore, Forumi Intelktual-E-30
123 - Partia e Ashkalinëjve për Integrim	138 - Partia Fjala
124 - Lidhja Demokratike e Kosovës	
125 - PDAK-LPB	

Numri i votuesve?

Pas përfundimit të regjistrimit të votuesve jashtë vendit, KQZ-ja bëri me dije se numri i votuesve për zgjedhjet e 9 shkurtit do të jetë 2 milionë e 75 mijë e 868 votues brenda dhe jashtë Kosovës.

Votuesit jashtë vendit, përveç votimit me postë, për herë të

parë do të mund të votojnë në 17 ambasada dhe 15 konsullata në 19 shtete të ndryshme të botës.

Votimi me postë nga jashtë vendit nis më 9 janar. Sipas KQZ-së, për votim jashtë vendit janë regjistruar 104 924. Nga ta, 20 399 janë regjistruar për votim fizik në ndonjë nga përfaqësitë diplomatike, të tjerët për votim me postë.

Kush identifikohet (e kush jo) me shtetin e Kosovës



Shkruan:
Milazim KRASNIQI

1. Fshatarët tashmë nuk duken aq të lidhur me shtetin tonë të ri. Remitencat, dalja në qytet, emigracioni, e kanë shpërbërë mënyrën e jetesës dhe e kanë zbehë interesin e fshatarëve për

shtetin. Shikojini fshatrat e periferisë se si janë shpopulluar dhe e keni të qartë se fshati po zhbëhet.

2. Emigracioni gjithnjë e më shumë e sheh Kosovën si destinacion turistik. Ndikimi i tyre është vetëm se kush nuk do të qeverisë, por aspak se si do të qeveriset. Duke votuar qeverinë që është nën masat e BE-së, militantizmi i tyre mund të kthehet në dëm për interesat shtetërore të Kosovës.

3. Rinia studentore duan të ikin një orë e më parë, prandaj aktivizmi i saj i para disa vitesh faktikisht është shuar.

4. Pensionistët janë të pafuqishëm. Pensionet nuk u mjaftojnë për të jetuar të pavarur, varësia nga familja i bën të bëhen të dëgjueshëm, të mbyllin gojën.

5. Biznesmenët, meqë nuk ka investime të huaja, nuk kanë konkurrencë, prandaj ndihen komod dhe indiferent. Ndër të tjera, shumë prej tyre vjedhin taksat. (Vetëm shikojini restorantet që nuk japin kupona fiskalë dhe e kuptoni.)

6. Elitat janë teknikistizuar, kombëtarisht janë debilizuar bukur shumë, për shkak të degradimit të universiteteve

ndër vite.

7. Prezenca ushtarake e KFOR na e bën të qartë mungesën e sovranitetit shtetëror të Kosovës. E pra njerëzit e presin sovranitetin si dhuratë, jo si rezultat të ndërtimit të shtetit. Prandaj nuk e duan shtetin josovran, ndërsa shtetin sovran nuk përpiqen ta bëjnë.

8. Shqipëria ka filluar të perceptohet si Tjetri. Ndërsa Kosova e ka të vështirë mbijetesën shtetërore, pa mbështetjen e Shqipërisë.

9. Serbia vazhdon të përjetohet me të drejtë si armik dhe rrezik potencial, por frika neurotike

prej saj ka rrezik se po e nxitë largimin e shqiptarëve nga Kosova.

10. Islamofobia është produkt i frustrimit, deprimimit. Dhe e dëmton kohezionin social e nacional dhe interesin shtetëror.

11. Nacionalizmi shqiptar është klinikisht i vdekur në Kosovë, ndërsa pa nacionalizëm kombi nuk regjenerohet. Pa komb shteti nuk funksionon.

12. Kapni secili mendoni se çka mund të bëjmë për këtë shtet, i cili për ne do të thotë ekzistencë.

KUJDES: MOS VOTONI PËR EMRA, POR PËR VLERA!



Shkruan: Astrit GASHI

Edhe pse është e vështirë të gesh 100 emra në të gjitha listat e partive që përfaqësojnë vlera të mirëfillta, kjo mbetet detyra

jonë si qytetarë të përgjegjshëm dhe të angazhuar për të ardhmen e vendit.

Ju lutem, kujdes të veçantë:

- Asnjë votë për nepotizmin, për "djalin e filanit" apo "çikën e fistekut," përveç nëse ata dëshmojnë se kanë vlera reale, profesionalizëm dhe kompetenca të padiskutueshme.

- Asnjë votë për klanet kriminale, që të gjithë i njihni, dhe që kanë dëmtuar rëndë interesat e qytetarëve dhe të

ardhmen e Kosovës.

- Asnjë votë për ata që, për vite të tëra, nuk kanë bërë asgjë për popullin, por vetëm kanë shfrytëzuar pushtetin për përfitime personale dhe klanore.

Është një fatkeqësi kombëtare që femra shqiptare në listat zgjedhore shpesh trajtohet si një numër për të plotësuar kuotat ligjore, e jo si përfaqësuese e vlerave dhe kapacitetit të vërtetë. Kjo duhet të ndryshojë

urgjentisht, duke mbështetur gra dhe burra me vizion, përkushtim dhe programe konkrete për të mirën e qytetarëve.

Mos të votoni fare? Nuk është zgjidhje!

Mosvotimi është dorëzim dhe shmangie nga përgjegjësia qytetare. Në vend të kësaj, kërkoni me kujdes brenda listave njerëzit që përfaqësojnë vlera, integritet dhe ide të qarta për zhvillimin e vendit. Është detyra jonë të shpëtojmë

Kosovën nga nepotizmi, korrupsioni dhe antivlerat.

Këshillë: Mos votojmë për 10 të parët në të gjitha listat zgjedhore. Ky është një nga format më të mira për të ndëshkuar listat e dobëta dhe për të treguar se qytetarët kërkojnë ndryshim, vlera dhe përfaqësim të denjë!

Zgjidhni me mençuri - e ardhmja e Kosovës varet nga zgjedhja juaj që të mos kemi parlament të dobët!

Ta shpëtojmë Kosovën!

IKSHPK-ja JEP KËSHILLA SE SI TË PARANDALOHET VIRUSI I RI KINEZ

PRISHTINË, 6 JANAR - Në Kinë ka shpërthyer një virus i ri, ai i human MetaPneumovirusin, apo shkurt hMPV. Ndonëse autoritetet më të larta botërore të shëndetësisë nuk e kanë cilësuar situatën lidhur me këtë virus si emergjencë globale shëndetësore, autoritetet shëndetësore kudo kanë forcuar sistemet e monitorimit të sëmundjeve ngjitëse dhe kanë rritur kujdesin.

Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës (IKShPK) në bashkëpunim me Zyrën e OBSH-së në Kosovë ka dhënë për qytetarët disa nga informacione bazë lidhur me metapneumovirusin me qëllim që publiku të jetë i informuar dhe t'i rrisë masat e kujdesit p a r a n d a l o h e t . "Metapneumovirusi njerëzor (hMPV) është virus i zakonshëm respirator. Ai është zbuluar për herë të parë në vitin 2001 nga shkencëtarët holandezë. Dihet se shkakton sëmundje të rrugëve të sipërme dhe të poshtme të frymëmarrjes. hMPV ndjek model sezonal vjetor si gripit dhe RSV, dhe zakonisht

arrin kulmin në dimër ose në fillim të pranverës", ka njoftuar IKShPK-ja.

Si përhapet hMPV?

hMPV ka më shumë gjasa të përhapet nga personi i infektuar te të tjerët përmes: Pikave gjatë kollitjes dhe teshtitjes; Kontaktit të ngushtë personal, si çuthja, prekja ose shtrëngimi i duarve; Prekja e objekteve ose sipërfaqeve që kanë virusin mbi to dhe më pas prekja e gojës, hundës ose syve.

Cilat janë simptomat?

Simptomat përfshijnë kollë, ethe, kongestion nazal dhe fishkëllimë. Shumica e rasteve të hMPV janë të lehta, me simptoma të ngjashme me të ftohtin e zakonshëm. Patogjenët respiratorë, përfshirë gripin sezonal, RSV dhe hMPV, mund të paraqesin rreziqe për personat më të ndjeshëm, përfshirë fëmijët e vegjël, personat me imunitet të dobësuar dhe të moshuarit.



Kush është në rrezik nga hMPV?

Rastet e rënda mund të rezultojnë me bronkit ose pneumoni veçanërisht te foshnjat, të moshuarit dhe personat me imunitet të dobësuar. Personat me kushte paraprake të mushkërive, si astma, sëmundja pulmonare obstruktive kronike (COPD) ose emfizema, janë në rrezik më të

shtuar për pasojë më të rënda.

Si ta parandaloni përhapjen e hMPV?

Për ta parandaluar përhapjen dhe për t'i shkurtuar rreziqet e shkaktuara nga patogjenët respiratorë duhet të ndiqen masa të thjeshta. Këto masa përfshijnë: qëndrimin në shtëpi kur jeni të sëmurë, ndjekjen e këshillave mjekësore për

kujdesin, mbajtjen e maskave në hapësira të mbushura me njerëz ose të ajrosura dobët, mbulimin e kollës dhe teshtitjes me pecetë ose bërthyl të përthyer, praktikimin e larjes së rregullt të duarve, shmangien e prekjes së syve, hundës ose gojës me duar të palara dhe marrjen e vaksinave të rekomanduara kundër gripit sezonal, sipas këshillave të mjekut dhe autoriteteve lokale të shëndetit publik.

A ka trajtim/vaksinë kundër hMPV?

Aktualisht nuk ka trajtim specifik ose vaksinë për hMPV dhe kujdesi mjekësor është kryesisht simptomatik dhe virusi zakonisht kalon vetë. Për t'i lehtësuar simptomat dhe nëse këshillohet nga profesionisti i kujdesit shëndetësor, pacientët mund të përdorin barëra pa recetë për ta kontrolluar dhimbjen dhe ethet. Për pacientët me fishkëllimë dhe kollë më të rëndë, mjekët mund të përshkruajnë inhalator të përkohshëm.

Bajrami: Qeveria Kurti nuk po investon, po ngarkon qytetarët me borxhe

PRISHTINË, 6 JANAR - Deputetja e Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Hykmete Bajrami, ka reaguar ndaj politikave ekonomike të qeverisë Kurti, duke theksuar se borxhi nuk është marrë nga shteti, por nga qytetarët. Sipas saj, kreditë në banka në fund të vitit 2024 kanë arritur në shumën 5.6 miliardë euro, një rritje prej 15.7 % krahasuar me vitin 2023, duke e përkeqësuar situatën

financiare të qytetarëve. Në një postim në rrjetet sociale, Bajrami shkruan: "Qeveria ka vazhduar me marrë borxhe, nuk kanë marrë vetëm kur s'kanë mundur t'i ketë 80 vota në Kuvend". Ajo theksoi se politikat e qeverisë kanë futur qytetarët në borxh. "Sipas Bankës Qendrore të Kosovës, kreditë në banka në fund të dhjetorit 2024 kanë arritur shumën prej 5.668 miliardë

eurosh. Vetëm në vitin 2024 janë shtuar 768 milionë euro kredi të reja", theksoi deputetja Bajrami. Bajrami ka shtuar se përkundër faktit që qeveria Kurti nuk ka investuar në asnjë projekt të madh si autostrada, spitale apo shkolla, qytetarët janë të detyruar të marrin borxhe për të mbijetuar për shkak të inflacionit të lartë, që ka

arritur në 21.5 % gjatë katër viteve të fundit. Bajrami, gjithashtu, kritikoi qeverinë për mënyrën se si po manipulohet me të dhëna ekonomike. "Qeveria ka bërë përpjekje të mashtrojë me numra katër vjet radhazi, por qytetarët e kanë të vërtetën e tyre ata që e kanë jetuar atë", ka shkruar deputetja. Në fund të postimit të saj, deputetja e LDK-së ka cituar Ronald Reagan, duke thënë:



"Nuk kemi inflacion sepse njerëzit po jetojnë shumë mirë, kemi inflacion sepse qeveria po jeton shumë mirë".

'Rasti Grandi', shembull i humbjeve milionëshe dhe i dështimit institucional të Kosovës e jo 'fitore' politike

Shkruan:
Safet GËRZHALIU

Përkundër këtij dështimi, lajmi i kthimit të mjeteve të kompania "Mabco Construction" po prezantohet nga disa si "fitore", një qasje që vetëm ushqen propagandën partiakë dhe maskon dështimet serioze të institucioneve. Në të vërtetë kjo situatë është një kujtesë e rëndësishme për nevojën e reformave urgjente në menaxhimin institucional dhe mbrojtjen ligjore të interesave të Kosovës.

Javën e kaluar, kompania "Mabco Construction", në pronësi të Behgjet Pacollit, fitoi një çështje arbitrazhi kundër shtetit të Kosovës në lidhje me rastin e "Grand Hotel"-it. Sipas vendimit, shteti i Kosovës duhet t'i kthejë kompanisë paratë që kishte paguar për pronësinë e objektit, ndërsa "Grand Hotel"-i mbetet nën pronësinë shtetërore.

Një analizë e thelluar ngre pyetje mbi arsyen pse ky objekt nuk është privatizuar. Nëse "Grand"-i do të ishte privatizuar, përfitimet për shtetin mund të ishin të mëdha: Investime të reja në një ndërtesë ikonë të kryeqytetit; Punësim i të rinjve, duke ndihmuar ekonominë



vendore; Përmirësim i imazhit të Kosovës si një destinacion i sigurt për investitorët, duke dëshmuar një kornizë ligjore mbështetëse për ta. Nga një tjetër këndvështrim ky rast pasqyron mangësitë serioze institucionale të Kosovës. Procesi i stërzgatur në arbitrazh ka dërguar mesazhe negative për investitorët e huaj dhe ata

shqiptarë, duke minuar besimin e tyre për të investuar në vend. Një tjetër çështje është mungesa e llogaridhënies. Fakti që shteti i Kosovës humb rreth 60 milionë euro në arbitrazhe ndërkombëtare çdo vit - ose afërsisht 5 milionë në muaj, kërkon një hetim të thelluar dhe ndëshkime për ata që dështojnë të mbrojnë interesat e vendit.

Ky rast nuk është arsye për mburrje, por një thirrje për reflektim të thellë dhe përgjegjshmëri. Institucionet e Kosovës duhet të veprojnë me seriozitet për të parandaluar dështime të ngjashme në të ardhmen dhe për të ndërtuar një mjedis më tërheqës për investime të huaja dhe zhvillim ekonomik të qëndrueshëm.

Është shqetësues fakti se me çfarë lehtësie premtohen pagesat milionëshe në proceset e Arbitrazheve pa kërkuar përgjegjësi se pse erdhi deri tek ky vendim dhe pse po përsëriten këto vendime.

Këto miliona euro që duhet të paguhet nuk vijnë nga xhepi i ministrave por janë pronë e Republikës së Kosovës dhe qytetarëve të saj.

Duhet të ngritet përgjegjësia institucionale dhe llogaridhënia e jo këto raste të ndëshkimit dhe penalizimit të Kosovës të përsëriten, madje disa herë brenda vitit.

Miliona euro do të paguhet por a dihet çka do të ndodhë me fatin e hotelit "Grand" në të ardhmen. A do të mbeten edhe më tutje një "bukuri që vret" në qendër të Prishtinës apo do t'i lihet kohës që në heshtje një ditë të jetë një objekt komercial dhe banesor e të përjetojë fatin e shumë fabrikave dhe objekteve të privatizuara me Spinoff special në Kosovën e pas luftës, të cilat u tjetërsuan dhe u shndërruan në lagje dhe objekte banesore e jo në fabrika të modernizuara që do të kontribuonin në prodhim, punësim dhe rritje të eksporteve në interes të shtetit dhe qytetarëve.

Republika e Kosovës e meriton një të ardhme më ndryshe ku për shtetin veprohet e nuk flitet.

Ende nuk ka një përparim në ApplePay dhe në PayPal

PRISHTINË, 6 JANAR - Shfrytëzimi i platformës së internetit për pagesa elektronike PayPal mbetet sfidë për Kosovën. Guvernatori i Bankës Qendrore, Ahmet Ismaili, ka dhënë disa hollësi sa i përket mosanëtarësisimit të vendit në këtë platformë. Përveç kësaj, Ismaili ka folur për trendet ekonomike, për fitimin e bankave komerciale për vitin 2024 dhe për integrimin e

sistemit bankar në veri. Një tjetër hap i rëndësishëm për Kosovën, ai thotë se është integrimi i vendit në zonën e pagesave të BE-së (SEPA). Derisa shpreson se Kosova do të arrijë të bëhet anëtare e plotë e SEPA-së në vitin 2025, për çka do të mundësojë kursime prej rreth 55 milionë eurosh në vit për qytetarët dhe bizneset.

Në një intervistë për "KosovaPress", Ismaili nënvizon se as në

platformën ApplePay nuk ka një përparim. Ai thekson se shkakuar i kësaj mungese një kod shtetëror në databazën e Kombeve të Bashkuara është duke paraqitur sfidë. "Megjithëse ka pasur një pjesë të zhvillimeve pozitive sa i përket GooglePay. Pra, janë tashmë dy banka në Kosovë të cilat kanë arritur që të hyjnë në platformën e GooglePay. Ende nuk ka një përparim në ApplePay dhe në PayPal, kryesisht ende që

është shkakuar i kësaj mungese një kod shtetëror në databazën e Kombeve të Bashkuara është duke paraqitur problem. Këto improvizime që po kryhen janë manuale që, megjithatë, kanë ndihmuar pak, por ende mbetet kjo çështje për t'u adresuar më tutje. Nëse shikojmë në aspektin e perspektivës kemi pritje që do të realizohet, kurse nëse e shikojmë nga aspekti i



sotëm, progresi është shumë i limituar në këtë fushë aktualisht", ka thënë Ismaili.

Viti i zgjedhjeve dhe sfidave drejt stabilitetit

PRISHTINË, 6 JANAR - Zgjedhjet e rregullta parlamentare, që do të mbahen më 9 shkurt, si dhe zgjedhjet lokale në 38 komuna të vendit, që pritet të organizohen në vjeshtë, do të jenë ndër ngjarjet kryesore në Kosovë përgjatë vitit 2025, vlerësojnë analistët politikë në Kosovë dhe Serbi.

Analistët nga Prishtina, Lulzim Pecin nga Instituti Kosovar për Kërkime dhe Zhvillime të Politikave (KIPRED) dhe Njomza Arifi nga Grupi për Studime Juridike dhe Politike, vlerësojnë se rezultatet që do të dalin nga zgjedhjet, qoftë parlamentare, qoftë lokale, do t'i diktojnë dinamikat e zhvillimeve të mundshme politike dhe të sigurisë në vend. Mendim të përafërt kanë edhe analistët nga Beogradi, politologu Ognjen Gogiq dhe Dushan Janjiq nga Forumi për Marrëdhënie Etnike. Megjithatë, ata i shohin si të mundshme incidentet në veri të vendit dhe cenimin e situatës së sigurisë, në rast se nuk parandalohen ato.

Zbatimi i obligimeve që dalin nga marrëveshjet e arritura në Bruksel në kuadër të dialogut për normalizimin e marrëdhënieve Kosovë - Serbi, do të jetë sfidues gjatë vitit 2025, për Qeverinë e ardhshme të Kosovës, por edhe për atë të Serbisë, vlerësojnë analistët.

Asociacioni, barrë e vjetër për qeverinë e re

Zgjedhjet parlamentare do ta përcaktojnë edhe fatin e ardhshëm të liderëve në skenën politike të vendit, vlerëson Lulzim Peci. Kjo është arsyeja pse ai pret që fillimi i vitit 2025 të karakterizohet me fushatë zgjedhore agresive të partive politike. Megjithatë, sipas tij, qeveria e re, kushdo që do ta drejtojë, do të përballet menjëherë me kërkesat që partnerët nga Bashkimi Evropian dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës i kanë parashtruar tash e sa kohë. "Kushdo që bëhet lider i qeverisë së ardhshme do të përballet me kërkesat për ecjen përpara me dialog (për normalizimin e marrëdhënieve me Serbinë) dhe sidomos me kërkesën për dorëzimin në Gjykatën Kushtetuese të draft-statutit për Asociacionin e Komunave me Shumicë Serbe", thekson Peci.

Në tetor të vitit 2023 BE-ja ua dorëzoi Kosovës dhe Serbisë një "draft-statut modern" për formimin e Asociacionit. Shtetet e Bashkuara, Gjermania, Franca dhe Italia - e mbështetën atë.

BE-ja dhe ShBA-ja i kanë bërë thirrje vazhdimisht Kosovës që ta dërgojë këtë draft-statut në Gjykatën Kushtetuese.

Njomza Arifi nga Grupi për Studime Juridike dhe Politike

në Prishtinës vlerëson se zgjedhjet parlamentare të 9 shkurtit do ta shpërfaqin edhe performancën e subjekteve të reja politike serbe.

Pjesëmarrjen në zgjedhje e kanë paraqitur në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve gjashtë subjekte politike serbe: Demokracia Serbe, Lëvizja Popullore Serbe, Për Liri, Drejtësi dhe Mbijetesë, Partia e Serbëve të Kosovës, Nisma Qytetare Drejtësia Popullore, si dhe Lista Serbe. "Ne konsiderojmë se nëse do të thyhej monopoli politik i Listës Serbe kjo do të kontribuonte në rikthimin e normalitetit në Kuvendin e Kosovës si dhe përmirësimin e marrëdhënieve ndëretnike në Kosovë", thekson Arifi.

Lista Serbe është partia më e madhe e serbëve të Kosovës, e cila gëzon mbështetjen e Beogradit zyrtar. Në dhjetë vjetët e fundit ajo ka fituar zgjedhjet dhe ka përfaqësuar komunitetin në nivelin qendror dhe atë lokal.

Në mbledhjen fillestare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) më 23 dhjetor kjo parti nuk është certifikuar për pjesëmarrje në zgjedhje pas kundërshtimeve të partisë në pushtet, Lëvizjes Vetëvendosje, me arsyetimin se Lista Serbe nuk e njeh shtetësinë e Kosovës. Kjo parti është ankuar më pas në Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), i cili e ka urdhëruar KQZ-në ta certifikojë këtë parti.

Më 31 dhjetor KQZ-ja ka thënë se vendimi i PZAP-së për certifikim të Listës Serbe për zgjedhjet e 9 shkurtit është i plotfuqishëm dhe duhet zbatuar.

Deputetët e Listës Serbe në legjislaturën e fundit kanë bojkotuar shumicën e seancave të Kuvendit të Kosovës.

Në katër komunat në veri - Mitrovicë e Veriut, Leposaviq, Zubin Potok dhe Zvečan - Lista humbi pushtetin, pasi kryetarët e komunave atje hoqën dorë nga mandatet si pjesë e dorëheqjes kolektive të serbëve nga institucionet e Kosovës në nëntor të vitit 2022, përfshirë edhe policinë dhe gjyqësorin.

Në vend të tyre pushtetin e morën kryetarët nga partitë politike shqiptare, të cilët dolën nga zgjedhjet lokale në ato komuna në prill të vitit 2023. Ata u kundërshtuan nga serbët lokalë dhe ishin shkas për tensione dhe përplasje të grupeve të serbëve me Policinë e Kosovës dhe pjesëtarët të misionit të NATO-s në Kosovë - KFOR.

Zgjedhjet lokale, rast për kthimin e serbëve në institucione

Politologu nga Beogradi, Ognjen Gogiq, vlerëson se raportet e partive politike serbe



dhe atyre shqiptare do të fillojnë të përcaktohen gjatë fushatës për zgjedhjet parlamentare të 9 shkurtit.

Një fushatë e ashpër, sipas tij, do t'i ashpërsonte edhe raportet ndërmjet tyre. Këto raporte, sipas tij, do të varen edhe nga fakti se kush do t'i prijë qeverisë së ardhshme të vendit, dhe a do të ketë bashkëpunim të partive serbe me atë qeveri. "Ky është faktori kryesor dhe këtë do ta kuptojmë në shkurt. Kjo do ta ruajë tonin gjatë tërë vitit. Më pas vijnë zgjedhjet lokale, të cilat sërish janë më të rëndësishmet për serbët dhe për veriun, për shkak se përmes tyre do të mund të arrihej deri të kthimi i serbëve në institucione", tha Gogiq.

Në shtator presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiq, në një adresim para kombit, kërkoi shpalljen e zgjedhjeve të reja lokale në veri të Kosovës, kthimin e serbëve në Policinë e Kosovës dhe gjyqësor, si dhe tërheqjen e njësisë speciale të Policisë së Kosovës nga rajoni i veriut.

Lulzim Peci vlerëson se zgjedhjet lokale të rregullta që do të mbahen në vjeshtë, do të kenë ndikim të madh në konfigurimin politik të Kosovës, përfshirë edhe veriun e saj të banuar me shumicë serbe. Ai konsideron që përfaqësuesit politikë të serbëve do të marrin pjesë në ato zgjedhje. "Do të kemi një situatë interesante, sepse në aspektin politik do të jenë përfaqësuesit serbë të popullatës lokale serbe në veri. Ndërkaq, në anën tjetër, shumica e policëve atje do të vazhdojnë të jenë të komunitetit shqiptar. Të njëjtën gjë e kemi edhe në drejtësi", thekson Peci, i cili shtoi se kthimi i serbëve të veriut në polici dhe gjyqësor kërkon zgjidhje politike, në mënyrë që të ecet para drejt stabilitetit të Kosovës në përgjithësi.

Edhe Gogiq e sheh pjesëmarrjen e serbëve në zgjedhjet parlamentare, e sidomos në ato lokale në komunat veriore të Kosovës, si një rrugë që mund të çojë drejt

uljes së tensioneve në atë pjesë të vendit.

"Ato zgjedhje bartin shansin. Se a do të kuptohet ky shans, është e vështirë të thuhet në këtë çast. Mbase (zgjedhjet) mund të jenë edhe pretekst për përplasjet e reja", thekson Gogiq.

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, në një konferencë për medie, më 24 dhjetor, ka komentuar mundësinë e veprimeve dhe incidenteve që mund ta sfidojnë sigurinë në Kosovë. "...pritet të ndodhin edhe në të ardhmen e afërt, veçmas para dhe pas Vitit të Ri", ka thënë Kurti.

Ai ka komentuar sulmin në kanal in e Ibër-Lepencit, që ndodhi më 29 nëntor 2024 në fshatin Varragë të komunës së Zubin Potokut, duke thënë se urdhrin për kryerje e ka dhënë Millan Radoiçiq, ndërkaq përgjegjës për financimin, planifikimin dhe logjistikën e sulmit është shteti i Serbisë.

Radoiçiqi ka pranuar përgjegjësinë për organizimin e sulmit në Banjskë të Zveçanit, më 24 shtator 2023, ku mbeti i vrarë rreshteri policor Afrim Bunjaku. Në përleshje e sipër më pas janë vrarë edhe tre sulmues serbë. Radoiçiqi aktualisht po hetohet në Serbi, ndërkaq autoritetet e Kosovës kërkojnë që ai t'i nënshtrohet drejtësisë në Kosovë.

Dialog apo incidente?

Bashkimi Evropian dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës në vazhdimësi u kanë bërë thirrje Kosovës dhe Serbisë t'i kthehen dialogut dhe t'i shmangin veprimet që tensionojnë situatën.

Njomza Arifi shpreh mendimin se pas ndryshimeve në institucionet e Bashkimit Evropian dhe ardhjes në krye të diplomacisë evropiane të Kaja Kallasit, mund të pritë që viti 2025 të jetë më pozitiv në kontekstin e dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë në krahasim me vitin 2024. "Mund të presim një ekip

ndërmjetësues më pozitiv nga BE-ja, ndërsa administrata (e presidentit të zgjedhur amerikan, Donald Trump me shumë gjasë do t'ia lë barrën e ndërmjetësimit Brukselit", u shpreh Arifi. Por, kështu nuk mendon Dushan Janjiq nga Forumi për Marrëdhënie Etnike në Beograd.

Ai konsideron se dialogu i lehtësuar nga Bashkimi Evropian është rrënuar, për shkak se vetë BE-ja nuk ka një politikë të qartë të "menaxhimit të konfliktit", e cila do të merrej me qetësimin e tensioneve dhe situatave që çojnë drejt destabilizimit.

Janjiq konsideron se "kriza e sigurisë" do të vazhdojë edhe në vitin 2025.

Duke iu referuar sulmeve në Banjskë dhe në kanal in Ibër-Lepenc si "akte terroriste", Janjiq thekson se incidentet janë bërë pjesë e politikës ose të konfliktit brenda marrëdhënieve politike ndërmjet Kosovës dhe Serbisë.

"Kjo do të thotë që do të kemi forma të ndryshme (të incidenteve), sikurse forma që kishte sulmi i fundit terrorist në kanal in Ibër-Lepenc, e para saj edhe në Banjska. Pra, nuk përjashtohet një seri e ngjarjeve të tilla deri në maj apo qershor", theksoi Janjiq.

Ai shtoi se tashmë është e qartë që nëse të dyja vendet, Kosova dhe Serbia, dëshirojnë t'i normalizojnë marrëdhëniet dhe të hyjnë në Bashkimin Evropian, atëherë ato duhet të bëhen pjesë e NATO-s.

Në pozicionet e tanishme, të dyja vendet, sipas tij, janë "të ekspozuara ndaj ndikimit rus dhe ndikimeve të tjera negative". Por, përdërisa pritja,

që gjatë vitit 2025 të dy vendet të anëtarësohen në NATO, nuk është reale, Janjiq beson që së paku do të arrihet një marrëveshje ndërmjet Kosovës dhe Serbisë "për pakon e sigurisë". "Mendoj se qysh moti ekziston vetëdija për një gjë të tillë në Londër. Është e qartë se ideja e tillë është e afërt edhe për mënyrën e qeverisjes së Trumpit. Kjo sigurisht se do të vijë në radhën e prioriteteve. Nuk do ta bëjnë këtë përmes këtyre mekanizmave që thonë 'më mirë 100 vjet bisedime' sikurse BE-ja. Kjo bëhet me grupin e QUINT-it dhe NATO-n. Nuk ka aty ndërmjetësues dhe të tillë të ngjashëm", theksoi Janjiq.

Ai shtoi se një marrëveshje e tillë do t'i definonte raportet e ndërsjella të institucioneve të sigurisë dhe të drejtësisë të të dyja vendeve, pa hyrë në pikëpamjet delikate dhe të kundërta të tyre lidhur me statusin e Kosovës. "Duhet të menaxhohet siguria për shkak të luftërave të cilat është e mundur të zgjerohen edhe në Ballkanin Perëndimor", përfundoi Janjiq.

Historia vazhdon: Tre modele të vazhdimit të historisë

Autor: Sabri Këçmari - (2022, Palgrave Macmillan)

Shkruar nga Kittisak
WONGMAHESAK

Rreth autorit

Shkëlqesia e tij, profesor ass. dr. Sabri Këçmari, është ambasador i Republikës së Kosovës në Japoni, dhe ka qenë një intelektual i rëndësishëm publik në vendin e tij për shumë vjet. Para këtij posti ai ishte ambasador i parë i Kosovës në Austri nga viti 2008 deri më 2013 dhe në Australi nga 2013 deri më 2018. Këçmari është, gjithashtu, një autor i dalluar, pasi ka shkruar gjashtë libra, me librin e tij më të fundit, "Hyrje në diplomaci", botuar nga "Springer" në vitin 2024. Ai doktoroi në shkencë politike dhe sociologji në Institutin e Shkencës Politike dhe Sociologjisë dhe përfundoi studimet në Rheinische-Friedrich-Wilhelms-Universität në Bonn, Gjermani.

Rreth librit

"Historia vazhdon: Tre modele të vazhdimit të historisë" e Këçmarit kritikon tezën "Fundi i historisë" të Francis Fukuyamas. Ai argumenton se historia, larg nga përfundimi me kolapsin e komunizmit, po formësohet në mënyrë aktive nga tre modele të fuqishme ideologjike: ultranacionalizmi rus, fundamentalizmi islamik dhe socializmi kinez. Libri shqyrton me përpikëri çdo model, duke gjurmuar rrënjët e tij historike, duke analizuar parimet e tij themelore dhe duke vlerësuar implikimet e tij për shekullin e 21-të.

Analiza e Këçmarit është e thellë dhe e nuancuar. Ai shmang me mjeshtëri përgjithësimet e thjeshtuara, duke pranuar ndërlidhjet dhe kontradiktat e brendshme të secilës ideologji. Ai integron me mjeshtëri kontekstin historik dhe argumentet filozofike, duke ofruar një rrëfim të pasur dhe informues. Libri thellohet në dinamikat politike, ekonomike dhe sociale të secilit model, duke eksploruar ndërveprimet e tyre me fenë dhe nacionalizmin.


Autori demonstroi në mënyrë efektive se si këto tre modele sfidojnë normat liberale demokratike, duke ofruar një vlerësim të kthjellët të konflikteve të vazhdueshme ideologjike që formësojnë botën bashkëkohore. Historia Vazhdon nuk është thjesht një kritikë studimore. Është, gjithashtu, një paralajmërim në kohë. Këçmari thekson potencialin e këtyre ideologjive për të nxitur destabilitet, konflikt, madje edhe dhunë në shkallë globale. Rëndësia e librit qëndron në

studimin e tij rigoroz, qasjen e ekuilibruar dhe aftësinë për të lidhur ngjarje dhe tendenca në dukje të ndryshme.

Libri është i strukturuar në tetë kapituj:

Kapitulli 1, "Hyrja", i Historia Vazhdon të Këçmarit, shtron skenën për kritikën e tij ndaj tezës "Fundi i historisë" të Francis Fukuyama-s. Këçmari fillon duke rrëfyer esenë e Fukuyama-s të vitit 1989, duke vënë në dukje kalimin nga një ton pyetës ("Fundi i historisë?") në atë deklarativ ("Fundi i historisë dhe njeriu i fundit") brenda tre viteve, duke pasqyruar realitetet gjeopolitike në zhvillim. Parashikimi optimist i esesë për triumfin e demokracisë liberale, megjithatë, nuk arriti të ndërlihte rënien e Bashkimit Sovjetik dhe ngritjen e sfidave të reja ideologjike. Këçmari thekson se ndonëse studimor, libri i Fukuyama përdor një qasje gazetareske në titullin kryesor dhe titujt e kapitujve, duke synuar një tërheqje më të gjerë të lexuesve. Ai thekson se përkundër stilit gazetaresk të librit, përmbajtja themelore është e rrënjësuar thellë në analizat shkencore dhe filozofike. Qëllimi i autorit ishte të kuptonte sesi koncepti i "fundit të historisë" i Fukuyama është thelbësisht teleologjik - duke nënkuptuar një pikë përfundimtare të paracaktuar të zhvillimit historik - dhe se si kjo qasje, megjithëse me ndikim, mund të jetë e paplotë. Hyrja përfundimisht përcaktoi se, ndonëse e thellë, teza e Fukuyama është shumë e thjeshtë. Këçmari e përgatiti lexuesin për një kuptim më kompleks të historisë, ku "fundi i historisë" nuk ka ardhur ende, dhe disa ideologji të fuqishme vazhdojnë në mënyrë aktive të formësojnë ngjarjet globale. Kapitujt pasues janë pozicionuar si një eksplorim i këtyre narrativave kundërshtuese dhe rëndësisë së tyre për të kuptuar evolucionin e vazhdueshëm të historisë.

Kapitulli 2, "Historia vazhdon", thellohet në thelbin e kritikës së Këçmarit ndaj tezës "Fundi i historisë" të Francis Fukuyama-s. Këçmari sfidon pohimin e Fukuyama se historia përfundoi me triumfin e demokracisë liberale, duke argumentuar se historia, megjithatë nuk ndërpritet, por ka hyrë në një fazë të re. Ai gjurmon me përpikëri prejardhjen intelektuale të Fukuyama-s, duke treguar se si argumentet e tij ndërthuren me filozofitë e Kantit, Hegelit dhe Marksit. Koncepti i Fukuyama për "fundin e historisë", argumenton Këçmari, është në thelb normativ, jo thjesht



përshkruar. Ai analizon idenë e Fukuyama-s për "luftën për njohje", duke theksuar dallimet midis interpretimeve të Hegelit dhe Marksit të konfliktit klasor dhe implikimet për tezën e Fukuyama-s. Kapitulli shqyrton gjithashtu portretizimet e kundërta të Fukuyamas të "njeriut të parë" dhe "njeriut të fundit", duke treguar se si këto figura mishërojnë fazat e kundërta të historisë njerëzore, nga lufta për njohje te vetëkënaqësia e epokës post-historike. Këçmari sfidon më tej pikëpamjen e Fukuyama-s mbi marrëdhëniet midis demokracisë, fesë dhe nacionalizmit. Ai thekson se pohimi i Fukuyama-s se demokracia liberale është faza përfundimtare e zhvillimit politik, anashkalon ringjalljen e ideologjive fetare dhe nacionaliste. Kapitulli shërben në fund të fundit si një çmontim i

pretendimit të Fukuyama-s për fundin e historisë, duke hedhur bazat për eksplorimin e tre modeleve ideologjike kundërvënës në kapitujt pasues. Kapitulli 3, "Totalitarizmi i shekullit të njëzetë: nazifashizmi dhe komunizmi", shqyrton ngritjen dhe rënien e regjimeve totalitare të shekullit të 20-të si një sfond vendimtar për të kuptuar sfidat e vazhdueshme ndaj tezës së Fukuyama-s "Fundi i historisë". Këçmari nis duke theksuar pesimizmin e shekullit të 20-të, duke krahasuar atë me optimizmin e shekullit të 19-të dhe ia atribuon këtë zhvendosje shkatërrimit të shkaktuar nga Luftërat I dhe II Botërore. Ai argumenton se Lufta e Parë Botërore e dobësoi Evropën, duke hapur rrugën rritjes së aktorëve të rinj dhe duke vendosur skenën për ngritjen e ideologjive totalitare. Kapitulli thellohet në karakteristikat

përcaktuese të totalitarizmit, duke u mbështetur në punën e studiuesve si Carl Friedrich, Zbigniew Brzezinski dhe Hannah Arendt. Ai nënvizon rolin vendimtar të ideologjisë dhe terrorit në ruajtjen e sundimit totalitar dhe natyrën e përhapur të dhunës të qenësishme në sisteme të tilla. Më pas, kapitulli krahason nazi fashizmin dhe komunizmin, duke theksuar ngjashmëritë e tyre (p.sh., përdorimin e ideologjisë, terrorit dhe kultit të personalitetit) dhe dallimet e tyre (p.sh., qëllimet e tyre përkatëse ideologjike dhe qasjet e tyre ndaj pronës private). Analiza e Këçmarit arrin në përfundimin se ndërsa si nazi fashizmi ashtu edhe komunizmi përfundimisht nuk arritën të vendosnin dominimin e qëndrueshëm global, trashëgimia e tyre e dhunës dhe represionit politik ndikoi thellësisht në shekullin e 20-të. Ky

dështim minon më tej tezën e Fukuyama-s, duke demonstruar se trajektorja e historisë është shumë më kontigjente dhe komplekse sesa parashtrroi ai. Kapitulli shërben si një urë historike për analizën e mëvonshme të Kijçmarit për sfidat ideologjike bashkëkohore. Kapitulli 4, “Fukuyama në vorbullën e teorive të marrëdhënies ndërkombëtare”, e vendos tezën e Fukuyama-s “Fund i historisë” brenda kontekstit më të gjerë të teorisë së marrëdhënies ndërkombëtare. Kijçmari kundërshton vizionin optimist të Fukuyama-s për një rend botëror liberal me zhvillimet pesimiste dhe të përqendruara në pushtet të realizmit. Realizmi, i cili thekson pushtetin shtetëror dhe natyrën anarkike të sistemit ndërkombëtar, e sheh ndjekjen e pushtetit si shtytësin kryesor të sjelljes shtetërore. Përqendrimi i Fukuyama-s në ideologjinë liberale dhe triumfin eventual të demokracisë kundërshton drejtpërdrejt këtë perspektivë realiste. Kijçmari eksploron zhvendosjen e dukshme të Fukuyamas nga një qëndrim thjesht ideologjik në një “realizëm Wilsonian” më pragmatik, ku ShBA është thelbësore në promovimin e vlerave liberale në nivel global. Megjithatë, edhe kjo qasje e rishikuar devijon ndjeshëm nga parimet tradicionale realiste. Ai krahason më tej pikëpamjet e Fukuyama me konstruktivizmin, një shkollë mendimi që nxjerr në pah natyrën e ndërtuar shoqërore të marrëdhënies ndërkombëtare dhe thekson rolin e ideve dhe normave në formësimin e sjelljes shtetërore. Në fund të fundit, kapitulli thekson pozicionin unik të Fukuyama-s brenda teorisë së marrëdhënies ndërkombëtare. Pikëpamja e tij optimiste, thaujse teleologjike, e historisë është në kontrast të fortë me këndvështrimet më të kujdesshme dhe shpesh pesimiste të shkollave të tjera të mendimit. Kijçmari argumenton se parashikimi i guximshëm i Fukuyama-s, ndonëse në fund të fundit i pasaktë, përfaqëson një përpjekje të vlefshme për të lidhur filozofinë politike me marrëdhëniet ndërkombëtare, një përpjekje që kritika e tij e mëvonshme do ta përpunojë dhe zgjerojë. Kapitulli 5, “Ultra-nacionalizmi si një model i vazhdimit të historisë”, shqyrton ringjalljen e ultra-nacionalizmit si një sfidë e rëndësishme ndaj tezës së Fukuyama-s “Fund i Historisë”. Kijçmari argumenton se ultra-nacionalizmi, megjithëse i dallueshëm nga patriotizmi, përfaqëson një forcë të fuqishme që formëson gjeopolitikën bashkëkohore, veçanërisht në Evropën Lindore dhe Euroazi. Ai e përkufizon ultra-nacionalizmin si ndjekje e njohjes dhe dinjitetit kombëtar që shpesh i jep përparësi pushtetit dhe zgjerimit mbi zhvillimin ekonomik ose të drejtat e njeriut. Kapitulli fokusohet kryesisht në ultra-nacionalizmin rus, duke gjurmuar rrënjët e tij historike



nga politikat ekspansioniste të Perandorisë Ruse deri te politika e jashtme aktuale e Vladimir Putin. Kijçmari detajon përafrimin ideologjik të Putinit me figura si Alexander Dugin dhe analizon implikimet e Putinizmit për stabilitetin rajonal. Kapitulli diskuton gjithashtu ultra-nacionalizmin serb, duke theksuar rolin e tij në luftërat në Jugosllavi dhe ndikimin e tij të vazhdueshëm në Ballkan. Kijçmari eksploron themelet ideologjike të ultra-nacionalizmit, duke theksuar rolin e narrativave historike dhe ndërtimit të “armiqve” në justifikimin e veprimeve agresive. Ai vë në kontrast aspiratat patriotike të shteteve baltike, të cilët kërkuar integritetin në Bashkimin Evropian, me synimet ekspansioniste të Rusisë dhe Serbisë. Kapitulli demonstroi sesi ultra-nacionalizmi, i ushqyer nga një ndjenjë ankese historike dhe një dëshirë për dominim kombëtar, formëson në mënyrë aktive ngjarjet gjeopolitike, duke kundërshtuar kështu pohimin e Fukuyama-s për një rezultat të përcaktuar historikisht. Ky shërben si një rast studimor vendimtar për të demonstruar dinamizmin e vazhdueshëm të historisë dhe fuqinë e qëndrueshme të ideologjive konkurruese. Kapitulli 6, “Fundamentalizmi Islamik si model i vazhdimit të historisë”, shqyrton ngritjen e fundamentalizmit islamik si një tjetër kundër-narrativë e fuqishme ndaj tezës së Fukuyama-s “Fund i Historisë”. Kijçmari argumenton se rënia e Bashkimit Sovjetik dhe ndryshimi që pasoi në sistemin ndërkombëtar krijuan një terren pjellor për shfaqjen e kësaj ideologjie, e karakterizuar nga refuzimi i vlerave liberale dhe gatishmëria e saj për të përdorur dhunën për të arritur qëllimet e saj. Kapitulli bën dallimin midis formave të ndryshme të fundamentalizmit islamik, duke nënvizuar dallimet midis islamit politik (i cili synon të krijojë shtete islame nëpërmjet veprimit politik) dhe fundamentalizmit islamik (i cili thekson respektimin e rreptë ndaj parimeve fetare, shpesh duke refuzuar përfshirjen e shtetit). Analiza fokusohet në qasje të kundërta të Al Kaedës

dhe ISIS-it, duke demonstruar se si këto grupe përfaqësojnë strategji të ndryshme për arritjen e objektivave të tyre ideologjike. Al Kaeda përdori një strategji rrjeti të decentralizuar, ndërsa ISIS u përpoq të krijonte një kalifat (shtet) territorial. Kijçmari eksploron rrënjët ideologjike të fundamentalizmit islamik, duke gjurmuar prejardhjen e tij intelektuale dhe duke analizuar tërheqjen e tij në segmente të ndryshme të botës myslimane. Ai shqyrton në mënyrë kritike rolin e fesë në formësimin e sjelljes politike, duke theksuar justifikimet e përdorura për të legjitimuar dhunën kundër atyre që konsiderohen “jobesimtarë”. Kapitulli përfundon duke argumentuar se pavarësisht pengesave të pësuar nga grupe si Al Kaeda dhe ISIS, fundamentalizmi islamik ndikon në politikën globale dhe paraqet një sfidë të rëndësishme për vizionin optimist të Fukuyama për të ardhmen. Kapitulli 7, “Socializmi kinez si një model i vazhdimit të historisë”, analizon ngritjen e Kinës si një fuqi e rëndësishme globale dhe sfidën e saj ndaj tezës “Fund i historisë” të Fukuyama-s. Kijçmari argumenton se përzierja unike e Kinës e sundimit autoritar, një sistemi njëpartiak dhe politikave ekonomike të orientuara nga tregu bie në kundërshtim drejtpërdrejt me parashikimin e Fukuyama. Kapitulli gjurmë rritjen ekonomike të Kinës, rritjen e ndikimit global dhe politikën e saj të jashtme ndikuese. Kijçmari shqyrton kontekstin historik të zhvillimit të Kinës, duke përfshirë ndikimin e Revolucionit Kulturor dhe protestave të Sheshit Tiananmen. Ai thekson rolin e nacionalizmit në konsolidimin e fuqisë së PKK dhe në formësimin e identitetit të Kinës dhe marrëdhënies të saj me aktorët e brendshëm dhe të jashtëm. Ai diskuton konceptin e “socializmit me karakteristika kineze”, duke argumentuar se ai përfaqëson një model të veçantë qeverisjeje, duke kombinuar ideologjinë socialiste me mekanizmat e tregut. Kapitulli eksploron aspekte kritike të shoqërisë kineze, duke përfshirë marrëdhënien e saj komplekse me demokracinë, të dhënat e të drejtave të njeriut, qasjen ndaj lirisë fetare dhe sfidat e

balancimit të rritjes ekonomike me shqetësimet mjedisore dhe pabarazinë sociale. Ai arrin në përfundimin se suksesi i Kinës në kombinimin e qeverisjes autoritare me rritjen ekonomike paraqet një sfidë ndaj modelit të Fukuyama. Kapitulli 8, “Përfundimi”, Kijçmari përmbledh argumentin e tij qendror: Teza e Fukuyama-s “Fund i Historisë”, triumfuese e vitit 1989, përfundimisht dështoi të japë shpjegime për mundësinë e ringjalljes së ideologjive. Tre modelet e analizuar - ultra-nacionalizmi rus, fundamentalizmi islamik dhe socializmi kinez - demonstroi se historia vazhdon. Ndërsa demokracia liberale arriti një fitore të rëndësishme në 1989, ajo nuk arriti dominim total. Kijçmari thekson ndikimin e qëndrueshëm të ultra-nacionalizmit rus, veçanërisht në Euroazi, ku putinizmi paraqet një sfidë të konsiderueshme ndaj normave liberale. Ai nënvizon prezencën e vazhdueshme të fundamentalizmit islamik, pavarësisht nga humbjet e ndjeshme të grupeve si Al Kaeda dhe ISIS, dhe vë theksin të socializmi kinez, që sfidojnë parashikimin e modelit të Fukuyama. Autori thekson se megjithëse “fund i historisë” mund të mos ketë ardhur, koncepti i tij është produkt i një konteksti specifik historik dhe ideologjik. Ai argumenton se politika globale do të vazhdojë të formësohet nga përplasja e qytetërimeve, dallimet kulturore dhe kërkesat konkurruese të pushtetit shtetëror. Ai kundërshton optimizmin e thjeshtëzuar të Fukuyama-s dhe pesimizmin po aq të thjeshtëzuar të teoricienëve të përplasjes së qytetërimit, duke u angazhuar për një kuptim më të nuancuar të ndërveprimit dinamik të vazhdueshëm midis modeleve të ndryshme ideologjike. Në fund të fundit, Kijçmari thekson nevojën për një qasje më të informuar historikisht dhe kontekstualisht për të kuptuar kompleksitetin e procesit historik në vazhdim. “Historia vazhdon: Tre modelet e vazhdimit të historisë” e Kijçmarit është një vepër studimore bindëse dhe e detajuar që sfidon në mënyrë unike tezën “Fund i historisë” të Francis Fukuyama-s. Libri sfidon

argumentet e Fukuyamas, duke ofruar një eksplorim të thellë të historisë së shekullit të 21-të, duke u fokusuar në tre modele ideologjike me ndikim: ultra-nacionalizmi rus, fundamentalizmi islamik dhe socializmi kinez.

Analiza e Kijçmarit shkon përtej vlerësimeve sipërfaqësore. Ai gërmon thellë në rrënjët historike të secilës ideologji, parimet thelbësore dhe degëzimet socio-politike, duke u ofruar lexuesve një kuptim të pasur të konteksteve dhe kompleksiteteve të tyre historike. Kjo shmang grackat e interpretimeve të thjeshtuara dhe promovon një perspektivë të nuancuar.

Shqyrtimi krahasues i këtyre tre modeleve të dallueshme ideologjike është veçanërisht i thellë. Duke vënë përballë dhe krahasuar pikat e forta dhe të dobëta të tyre, libri nxit një kuptim të sofistikuar të dinamikës së ndërlikuar që i jep formë botës moderne, duke shkruar përtej analizave me një perspektivë të vetme.

Ndërlidhja e librit me ngjarjet bashkëkohore - lufta në Ukrainë, përhapja e vazhdueshme e fundamentalizmit islamik dhe vetëbesimi në rritje të Kinës - e bën atë shumë të rëndësishëm dhe në kohë, duke ofruar njohuri kritike për çështjet kryesore globale.

Historia vazhdon sforcon ndjeshëm të menduarit kritik dhe aftësitë analitike. Qasja e tij rigoroz ndaj analizës krahasuese i pajis lexuesit me mjete të paçmueshme për të lundruar në peizazhe komplekse politike dhe ideologjike, duke përfituar studentët dhe studiuesit nëpër disiplina të ndryshme, duke përfshirë shkencën politike, historinë dhe sociologjinë.



Libri zgjeron njohuritë e lexuesve për historinë moderne globale, ideologjitë dhe politikën. Ky eksplorim i detajuar është i çmuar për studentët dhe profesionistët që kërkojnë një kuptim më të thellë të këtyre temave thelbësore.

Puna e Kijçmarit nxit një kuptim më të sofistikuar të dinamikave bashkëkohore globale. Kjo perspektivë e nuancuar është thelbësore për profesionistët në shumë fusha, veçanërisht ato të marrëdhënies ndërkombëtare, shkencës politike dhe diplomacisë.

Si përfundim, Historia vazhdon është një libër i vlefshëm dhe tërheqës për akademikët dhe profesionistët e interesuar në historinë, shkencën politike dhe marrëdhëniet ndërkombëtare. Studimi rigoroz, analiza e nuancuar dhe kritika e thellë e tezës së Fukuyama-s e bëjnë atë të kontribuojë ndjeshëm në këtë fushë. Rëndësia në kohë dhe fokusi i librit në sfidat bashkëkohore globale e bëjnë atë lexim thelbësor për këdo që kërkon një kuptim më të thellë të botës sonë gjithnjë e më komplekse.

REFERENCA

Kijçmari, S. (2022). History Continues: Three Models of the Continuation of History. Palgrave Macmillan.



Çeku, Ramës: Të lutem, Kryetar, mos gënje!

“Epoka e re”

PRISHTINË, 6 JANAR - Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Hajrulla Çeku, në “Facebook” ka kërkuar nga kryetari i komunës së Prishtinës, Përparim Rama, të mos gënjejë lidhur me palestrën multisportive dhe zonën ekonomike. Në fakt, kryetari Rama ditë më parë ka deklaruar se: “Lokacioni dhe plani për palestrën janë refuzuar katër herë nga asamblistët e Vetëvendosjes. Në seancën e fundit (04.12.2024), kjo bllokadë u shoqërua me shkatërrim të pronës publike dhe ndërhyrje të policisë!”. Gjithnjë sipas tij, komuna e Prishtinës ka planifikuar ndërtimin e palestrës si pjesë të një kompleksi sportiv në Bernicë, me projekte të plota urbanistike dhe përpjekje të vazhdueshme për miratim. “Përhapja e propagandës dhe mungesa e bashkëpunimit politik po dëmtojnë Prishtinën dhe qytetarët e saj. Faji për vonesat bie mbi bllokimin e qëllimshëm nga Vetëvendosje dhe jo mbi Komunën. Komuna do të vazhdojë të punojë për të realizuar projektet e rëndësishme, pavarësisht bllokimeve politike. Retorika e gabuar dhe veprimet destruktive nuk do të na ndalin! Qytetarët e Prishtinës meritojnë zhvillim, jo propagandë politike. Dokumentet që vërtetojnë përpjekjet



tona janë publike dhe të qasshme për të gjithë!”, kishte deklaruar Rama. Ndërsa ministri Çeku të hënën është kundërpërgjigjur duke thënë se lokacioni nga Rama dhe Federata e Basketbollit gjendet në Hajvali dhe nuk ka të bëjë fare me lokacionin ku dëshiron ta realizojë projektin e kompleksit sportiv në Bernicë. “Të lutem, Kryetar, mos gënje! Lokacioni i dakorduar nga ju dhe Federata e Basketbollit për realizimin e Palestrës Multisportive gjendet në Hajvali, pranë Qendrës Nacionale të Futbollit dhe nuk ka të bëjë fare me lokacionin

ku dëshironi ta realizoni projektin e kampusit sportiv në Bernicë, përkatësisht Fshatin Olimpik. Gjatë tërë vitit 2024 Komuna e Prishtinës nuk ndërmori asnjë hap për ta konkretizuar zotimin tuaj dhe plotësuar kërkesën e FBK-së. Me gënjeshtër nuk ecet përpara. Nëse jeni serioz, dërgojeni vendimin në Kuvendin e Komunës për lokacionin që jeni dakorduar me FBK-në duke mundësuar kështu realizimin e plotë të projektit nga MKRS. PS. Nga grupi i VV më thanë që do të votojnë PËR. Dërgoje!”, ka shkruar Çeku.

Khaka shpallet më i miri në Zvicër, Ragip Xhaka: Vazhdo të na bësh krenar

CYRIH, 6 JANAR - Granit Xhaka është zgjedhur mbrëmë futbollisti më i mirë i vitit në Zvicër në gala mbrëmjen “Sports Awards 2024”. Ylli nga Kosova shkëlqeu në 2024-shin me paraqitje mbresëlënëse me Bayer Leverkusenin dhe me kombëtaren e Zvicrës, prandaj nuk kishte dyshim se ai do ta zgjidhej më i miri i shtetit “Helvetik”. Babai i ish-futbollistit të Arsenalit, Ragip Xhaka, është shprehur krenar me të arriturën e djalit të tij. “Urime djali im, Granit, për çmimin ‘Lojtari më i vlefshëm’ në Zvicër për vitin 2024! Me fanellën tënde me numrin 34, ti ke shkruar histori këtë vit – duke fituar kampionatin dhe kupën me Bayer Leverkusen, duke udhëhequr skuadrën si lider në çdo hap të rrugës, dhe duke arritur çerekfinalin me Kombëtaren e Zvicrës në Kampionatin Evropian. Madje, nominimi yt për Ballon d’Or është një tjetër arritje që na bën të gjithëve



krenarë! Jam krenar për përkushtimin dhe pasionin tënd që frymëzon miliona njerëz. Vazhdo të

na bësh krenar dhe të shkëlqesh gjithmonë!”, ka shkruar Ragip Xhaka.

SHKURT

Arijanet Muriqi në formacionin e vitit 2024

Portieri i Përfaqësueses së Kosovës, Arijanet Muriq, është shpërblyer për paraqitjet e mira që i ka pasur përgjatë vitit 2024 me skuadrën angleze Ipswich Town. Ai është përfshirë në formacionin më të mirë të vitit 2024 nga top 20 ligat më të mëdha në botë, të publikuar nga faqja e specializuar për vlerësimet e futbollistëve, “Sofascore”. Në këtë formacion janë vlerësuar futbollistët për paraqitjet që i kanë pasur gjatë vitit të shkuar si me kombëtare ashtu edhe me klube. Portieri kosovar, Muriq, është vlerësuar me notën 7.48, duke zënë vend në portën e formacionit më të mirë të vitit. Pjesë e këtij formacioni janë edhe lojtarët e njohur si Achraf Hakimi, Alejandro Grimaldo, Rodri, Lionel Messi, Bruno Fernandes e Viktor Gyokeres. Portieri Muriq në vitin 2024 ka regjistruar 17 paraqitje me fanellën e Ipswichit, ndërsa me kombëtaren e Kosovës ka katër ndeshje të luajtura.

Gjasula nënshkruan për klubin gjerman

Klaus Gjasula është lojtari më i ri i Rot-Weiss Essen. Klubi i kategorisë së 3-të gjermane ka zyrtarizuar afrimin e mesfushorit shqiptar nëpërmjet një postimi në kanalet zyrtare të klubit. Gjasula vjen nga Darmstadt dhe është gati për përvojën e re. Ai më herët është aktivizuar për Paderbornin apo edhe Hamburgun. “Mezi pres ta shikoj atmosferën e mrekullueshme në Hafenstrasse. Do të bëj gjithçka që të mbledhim pikë sa më shpejt që të jetë e mundur për të qëndruar në ligë”, ka thënë Gjasula pas firmës me Essenin. 35-vjeçari do ta mbajë veshur fanellën me numër 5.

Rashica kërkohet nga disa klube angleze

Milot Rashica mund të rikthehet në futbollin anglez gjatë këtij muaji. Mediumet në Turqi të hënën kanë raportuar se disa skuadra angleze kanë shprehur interesim për shërbimet e Rashicës, i cili është pjesë e Beshiktashit. Emrat e skuadrave angleze nuk janë bërë publike, por thuhet se drejtuesit e Beshiktashit po shqyrtojnë ofertat e tyre për Rashicën dhe pritet së shpejti të marrin një vendim për të ardhmen e 28-vjeçarit. Te Beshiktashi duan ta mbajnë Rashicën, në anën tjetër një ofertë e mirë për kartonin e tij mund ta bindë ekipin turk për ta liruar sulmuesin e krahut gjatë këtij afati kalimtar. Rashica në vitin 2023 iu bashkua Beshiktashit nga Norwich City për 5 milionë euro dhe me skuadrën turke ka kontratë deri në verën e vitit 2028. Këtë sezon Rashica në 18 ndeshje të luajtura për Beshiktashin në të gjitha garat ka shënuar 1 gol dhe ka bërë 5 asistime.

KB Prishtina përforcohet me ish-lojtarin e Euroligës, Rashid Mahalbashiq

PRISHTINË, 6 JANAR - Me skuadrën polake Prokom, Rashid Mahalbashiq u paraqit në ligën më të fortë basketbollistike të Evropës. Slloveni me pasaportë austriake tani do të jetë qendra e re e Prishtinës. Lojtari i cili së fundmi luajti në elitën meksikane të këtij sporti, "Liga

Nacional de Baloncesto Profesional", ka një karrierë të pasur, pasi ishte pjesë e disa ekipeve në Evropë dhe jashtë kontinentit të vjetër. Reprzentuesi i Austrisë mbrojti ngjyrat e skuadrës së famshme turke Fenerbache, pastaj të Real Betisit në Spanjë, Monacos në Francë e dy herë

fituesit të Ligës së Kampionëve, CB San Pablo Burgos. Kryeqytetasit nuk zhvilluan një sezon të kënaqshëm vjeshtor, pasi përfunduan në vendin e gjashtë, me gjashtë fitore e tetë humbje, duke lënë prapa vetëm skuadrat modeste, si Bora dhe Proton Cable

Prizreni. Kjo bëri që klubi më i trofeshëm në Kosovë t'i ndezë motorët, duke larguar fillimisht disa lojtarë për të afruar të tjerë. Nga skuadra u larguan Henrik Shirko, Rashad Williams e Eliot Peci, kurse deri tani janë paraqitur Tyrrel Tate, rikthimi i Donte Clark dhe, i fundit, Rashid



Vasseur, optimist për Ferrarin, zbulon planin për vitin 2025 dhe të ardhmen

MARANELLO, 6 JANAR - Pasi dueli fort për titullin kampion për konstruktorë, ku vitin e kaluar u klasifikua në vendin e dytë, këtë sezon Ferrari synon një rikthim të fuqishëm në majë, falë ardhjes së Lewis Hamiltonit, që do ta ndihmojë Charles Leclercin, në një dyshe kampionësh për "kokëkuqen". Drejtori sportiv i Ferrarit, Frederic Vasseur, foli për këtë sezon dhe risitë që sjell ai: "Muajt e parë do të jenë thelbësorë për zhvillimin e makinës së këtij viti, por më pas fokusi ynë do të zhvendoset te projekti i sezonit të ardhshëm". Siç dihet, makinat e Formulës 1 të vitit 2026 do të jenë 30 kg më të lehta dhe do të kenë një gjerësi të reduktuar nga 2 000 mm në 1 900 mm dhe një bazë të reduktuar të rrotave nga 3 600 mm në 3 400 mm. Rrotat 18 inç do të mbeten, por gjerësia e gomave do të



shkurtohet 25 mm përpara dhe 30 mm në pjesën e pasme. Do të aplikohet, gjithashtu, sistemi "Push-To-Pass", që do t'u sigurojë pilotëve një sasi shtesë energjie për një xhiro, duke i lejuar ata të tentojnë parakalimin kur janë mjaftueshëm afër një makine

tjetër. "Unë nuk bëj dot parashikime, por në 2-3 muajt e parë të këtij viti do të punojmë për projektin e 2025-s. Më pas do të shohim se çfarë të bëjmë edhe në lidhje me nevojat tona", ka sqaruar drejtori i ekipit të skuadrës së Maranellos.

Clevelandi dhe Oklahoma dominojnë në NBA

OKLAHOMA, 6 JANAR - Kampionët e Bostonit janë mposhtur me rezultat 105-92 në fushën e Oklahomas, ekip që kryeson renditjen në Konferencën e Perëndimit. Fitore e merituar e skuadrës vendase, ku sërish protagonist ishte Alexander Shai me 33 pikë e 11 rebounde. Në Lindje



vijon të dominojë ekipi i Clevelandit, që mundi me rezultat 115-105 Charlotten dhe u shkëput ndjeshëm nga ndjekësit. Garlandi me 25 pikë ishte më i miri në fushë për Cavaliersin. Zhgënjëu skuadra

e lakersave, që u mund me shifrat 119-115 nga Houstoni. Edhe pse Davisi realizoi 30 pikë nuk mjaftuan për të fituar. Për tekstanët u dallua Jalen Green me 33 pikë, mbështetur edhe nga Thompsoni me 23 pikë. Disfatë e rëndë në shtëpi për Golden State, që u mund me shifrat 129-99 nga Sacramento. Nga lojtarët e stolit erdhën 48 pikë për miqtë, ndërkohë që Malik Monk me 26 pikë ishte më i miri, duke i bërë të pavlefshme 26 pikët e Curryt për vendësit.

REZULTATET

Oklahoma - Boston	105-92
Cleveland - Charlotte	115-105
Washington - New Orleans	98-110
Orlando - Utah Jazz	92-105
Houston - Lakers	119-115
Golden State - Sacramento	99-129

Reali e ka të gatshëm trajnerin që do ta zëvendësojë Ancelottin

Rreth dy muaj më parë dukej se Real Madridi është vënë në kërkim për një trajner të ri gjatë sezonit për herë të parë brenda gjashtë viteve. Sidoqoftë, Carlo Ancelotti ktheu përmbys situatën dhe tashmë Reali gjendet në krye të tabelës në La Liga,

megjithatë kjo nuk ka ndryshuar planet e bordit të klubit për këtë pozitë. Ancelotti ka një pozitë deri në 2026 dhe në rast se gjërat shkojnë mirë në pjesën e dytë të sezonit, ai do të mbetet në stol për sezonin e ardhshëm. Nëse rezultatet

nuk do të përmirësoheshin në nëntor, atij i ishte kërkuar ta mposhtë Gironan ose do të shkarkohej sipas Relevo dhe pastaj ata kishin për synim ta zëvendësonin atë me Santiago Solarin deri në fund të sezonit. Megjithatë, Alonso është favoriti kryesor

për ta zëvendësuar italianin. I njëjti medium raporton se Alonso është i lumtur të presë deri në castin e largimit të Ancelottit. Xabi është i lumtur të Leverkuseni dhe do të donte t'i shkonte deri në fund kontratës së tij, teksa në përfundim të saj do

ta merrte telefonatën nga Real Madridi. Në rast se Ancelotti fiton Ligën e Kampionëve ose La Ligan këtë sezon, atëherë ai do t'i shkojë deri në fund kontratës së tij, nëse jo, atëherë Alonso do ta zëvendësojë në verë.

SHKURT

Bologna synon transferimin e Asllanit

Kristjan Asllani nuk do të mund të luajë titullar fiks tek Interi për sa kohë në radhët e këtij klubi gjendet Hakan Çalhanollu dhe kjo duket se po shtyn shumë skuadra të tjera të tentojnë afrimin e mesfushorit shqiptar. Një prej tyre raportohet se është Bologna, e cila kërkon përforcime për pjesën e dytë të sezonit ku do të tentojë t'i afrohet përsëri zonës së Ligës së Kampionëve, në të cilën po luan në këtë edicion. Gazeta e qytetit të Bolognas, "Il Resto Del Carlino", ka bërë me dije se klubi ka piketuar Asllanin si një prej përforcimeve për pjesën e dytë të sezonit. Kuptohet që lojtari i ofrohet mundësia që të luajë titullar në radhët e kësaj skuadre, por edhe te Bologna janë të ndërgjegjshëm se do të jetë e vështirë të shkëputet mesfushori shqiptar nga klubi ku ai mbetet një alternativë e rëndësishme për trajnerin Inzaghi në luftën drejt mbrojtjes së titullit dhe një ecurie të suksesshme në Ligën e Kampionëve.

Lehecka e Sabalenka triumfojnë në Brisbane

Javën e ardhshme do të nisë në Melburn grand slam i Australian Open, turneu i parë i madh i këtij viti. Të gjithë tenistët thuajse kanë mbërritur në Australi për këtë event apo janë duke luajtur në turnetë e fundit përgatitore. Disa prej tyre kanë përfunduar, siç është ai i Brisbanes, që u zhvillua në të dy kategoritë. Për meshkuj, fitues doli çeku Jiri Lehecka, që në finale përfitoi nga tërheqja e amerikanit Reilly Opelka, i dëmtuar në setin e parë (ndeshja u ndal në rezultat 4-1 për çekun). Për femra turneu u fitua nga bjellorusja Aryna Sabalenka. Në finale ajo mundi 2-1 (4-6, 6-3, 6-2) rusen Polina Kudermetova. Një triumf me përmbysje i numrit 1 në botë, që konfirmoi se është në formë. Rikthehet te suksesi edhe japonezja Naomi Osaka, që triumfoi në turneun Auckland. Në finale ajo mundi Clara Tauson, që u tërhoq pas setit të parë (6-4), e dëmtuar. Ndërkohë, tenisti francez Alexandre Muller fitoi turneun e Hong Kongut. Në finale ai mposhti 2-1 (2-6, 6-1, 6-3) japonezin Kei Nishikori.

Van Dijk: Ndaj Unitedit mund të kishte përfunduar edhe më keq

Mbrojtësi i Liverpoolit, Virgil van Dijk, foli për BBC pas barazimit 2-2 të "Reds" kundër Manchester Unitedit në Premierë Ligë. Një ndeshje me një mijë fytyra, e cila pa skuadrën e Slot fillimisht të rikuperojë disavantazhin dhe më pas të rikuperohej nga "Djajtë e Kuq". "Mund të kishte përfunduar shumë më keq nëse ata do të kishin realizuar në fund. Duhet të jemi absolutisht të sinqertë me veten. Ata patën një shans të madh në fund, që mund të ishte shumë më keq për ne. Do të kishim dalë pa pikë", ka thënë Van Dijk. "Unë jam padyshim i zhgënjyer që kemi humbur pikë në shtëpi, por është ashtu siç është dhe ne duhet ta vazhdojmë rrugën tonë", ka deklaruar mbrojtësi holandez, që më tej shtoi: "Pasi dolëm në avantazh duhej të kishim menaxhuar lojën me pasime, por gabuam". "Ndonjëherë ne e humbim topin shumë lehtë dhe pastaj ishim më të ekspozuar nga sa duhej të ishim. Ne nuk jemi perfekt. Ne ende po mësojmë dhe duhet të mësojmë edhe nga kjo ndeshje", ka pohuar Van Dijk.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



www.facebook.com/gjejpuneshpejte

RESTAURANT

SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156  +386 49 848 553

PRISHTINË

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “Nestate” SH.P.K. me seli në Gjakovë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 812070382 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Nestate” D.O.O. Gjakove, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 812070382 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability “Nestate” L.L.C. with headquarters Gjakovë, has come to the decision to quit its business: 812070382 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgage – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Admir Dafota nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e shkollës së mesme të mjekësisë “Hysni Zajmi”. Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)
- Enerson Gavrani nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e kl. 9 të shkollës fillore “Zef Lush Marku”. - Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.
- Behixhe Pula nga Gjakova shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit “Nehixhe Pula” B.I. me nr Unik 811329615. - Lëshohet banesën një dhomshe me qira , ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroi i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.
- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.
- Lëshoj me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.
- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300

Lumë's Details
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898

Sallon Depilimi Lumë's Details

lumesdetails

Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi





ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA

1992

